



Prishtinë: 19.12.2008.

Kodi i ZRRE-së: V_154_2008

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_162_12_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_R_162_12_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2008 nxori këtë:

VENDIM

PRANOHET pjesërisht ankesa e konsumatorit Atdhe Kelmendi - Hotel "Gold" (shifra e konsumatorit DPE – 9002865) nga Peja, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK në ZRRE me datë 23.01.2008 ka apeluar përgjigjen e KEK – Divizionit të Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 12.01.2008, lidhur me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.

- Me datë 31.08.2007, ekipi i kontrollës së KEK-ut ka dalë në vendin e ngjarjes tek konsumatori dhe ka përpiluar procesverbalin nr. 000730 në të cilin theksohet se ekipi i kontrollës ka hasur në njehsor elektrik të ri të pa-lajmëruar në KEK.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 000730 i datës 31.08.2007.
- Me datë 24.12.2007, KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin (shifra e konsumatorit në KEK: DPE – 9002865) me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPE07HP02441 në shumë prej 10,077.04 €.
Provë: Fatura e KEK-ut DPE07HP02441 e datës 24.12.2007.
- Me datë 28.12.2007, konsumatori ka parashtruar ankesë në departamentin për konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK.
- Me datë 12.01.2008, departamenti për konsumatorë në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në Rregulla dhe procedura lidhur me ndërrimin e njehsorit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 12.01.2008.
- Me datë 23.01.2008 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së.

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:



- ✓ Sipas procesverbalit të KEK-ut nr. 000730 theksohet se konsumatori ka ndërruar njehsorin elektrik pa autorizimin e KEK-ut dhe se njehsorët e vjetër nuk janë prezantuar nga konsumatori.
Provë: Procesverbalet e KEK-ut nr. 000730 të datës 31.08.2007.
- ✓ Konsumatori në deklaratën e tij thekson se me datë 15.07.2007 e ka lajmëruar shërbimin për konsumator në KEK, se për shkak të një defekti që i ka ndodhur duhet të ndërroi njehsorin elektrik. Sipas konsumatorit, me rastin e lajmërimit për ndërrim të njehsorit, punëtorët i KEK-ut i kanë thënë se konsumatori duhet vetë ta ndërrojë njehsorin elektrik. Konsumatori po ashtu deklaron se nuk ka qenë në dijeni se duhet të ruhen dhe dorëzohen njehsorët e hequr elektrik.
Provë: Deklarata e konsumatorit.
- ✓ Me datë 24.12.2007 një komision i KEK-ut ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit dhe duke u bazuar në procesin e datës 31.08.2007 të përpiluar nga ekipi i kontrollës së KEK-ut dhe për shkak të mos-prezantimit nga ana e konsumatorit të njehsorit të vjetër të ndërruar nga ana e konsumatorit ka vendosur ta ngarkojë konsumatorin për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë. Komisioni për llogaritje të shfrytëzimit të paautorizuar ka marrë për bazë mesataren e kilovatëve të shpenzuar për pesë muajt e fundit të regjistruar në njehsorin e ri, duke u kthyer mbrapa për llogaritje për 24 muaj.
Provë: Vendimi i KEK-ut i datës 24.12.2007.
- ✓ Në bazë të vendimit të komisionit me datë 24.12.2007, KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me një ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPE07HP02441 në shumë prej 10,077.04 €. **Provë:** Fatura e KEK-ut DPE07HP02441.
- ✓ Me analizimin e listave të leximit dhe rrjedhjes së energjisë aktive të njehsorit të ndërruar vërehet se ky njehsor që nga fillimi ka disa anomalitë që mund të jenë si pasojë e mos-leximit apo i mosfunksionimit të mirë të njehsorit:
 1. Ka regjistruar vetëm në një tarifë (deri në muajin e 8/2005 vetëm tarifa e lartë dhe pas muajit të 8/2005 deri në muajin e 2/2006 vetëm tarifa e ulët);
 2. Pika matëse e konsumatorit nuk është lexuar nga muaji i 6/2007 deri në muajin e 12/2007;
 3. Edhe pse me datë 31.08.2008 ekipi i kontrollës ka përgatitë procesin me të cilin thekson se konsumatori e ka ndërruar njehsorin, prapëseprapë në listat e leximit të KEK-ut vazhdon të figuron numri i njëjtë i njehsorit i cili është ndërruar, vetëm në muajin e 12/2007 është bërë shënimi për njehsorin e ri.
Provë: Listat e leximit dhe rrjedha e energjisë aktive të konsumatorit.
- ✓ Konsumi i konsumatorit ndryshon dukshëm (zvogëlohet) pas muajit në vitin 2004, mirëpo KEK-u nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për të kontrolluar pikën matëse të konsumatorit.
- ✓ Konsumatori nuk e ka ruajtur njehsorin e hequr për ta prezantuar para KEK-ut, me këtë ka bërë shkelje të procedurave në fuqi dhe ka rritë dyshimin për mundësinë e abuzimit të mundshëm të pikës matëse.
- ✓ Ekipi i kontrollës së KEK-ut i cili ka përpiluar procesin e datës 31.08.2007, me të cilin është konstatuar që konsumatori ka ndërruar njehsorin ka qenë i obliguar që të bëjë regjistrimin e pajisjeve elektrike të konsumatorit, kjo ka qenë e nevojshme për të zbatuar procedurën në fuqi në atë kohë për kalkulimin e konsumit të paautorizuar të energjisë elektrike sipas Gazetës Zyrtare e KSAK-u e vitit 1982.



- ✓ Në mungesë të regjistrimit të pajisjeve sipas procesit të datës 31.08.2008, komisioni i cili ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit, për llogaritjen e energjisë së konsumuar në mënyrë të paautorizuar (rikthim i humbjeve) ka marrë për bazë konsumin mesatar mujor të regjistruar sipas njehsorit të ri. Kjo mesatare ka dalë **4,581.4 kWh/muaj** dhe është kalkuluar për 24 muaj mbrapa prej momentit kur është ndërruar njehsori, mirëpo komisioni në këtë rast nuk e ka shkarkuar mesataren e energjisë së faturuar për këta muaj, mesatarja mujor e faturuar ka qenë **2,350.8 kWh/muaj**.
- ✓ Sipas analizës së DMK-së është konstatuar se: kur të merret parasysh konsumi i faturuar i konsumatorit për 24 muajt para ndërrimit të njehsorit dhe mesatarja e llogaritur sipas regjistrimit në njehsor të ri atëherë **vlera e mbetur për faturim është 2,230.6 kWh/muaj**.
- ✓ Konsumatori nuk e ka ruajtur njehsorin e hequr për ta prezantuar para KEK-ut, me këtë ka bërë shkelje të procedurave në fuqi dhe ka rritë dyshimin për mundësinë e abuzimit të mundshëm të pikës matëse.
- ✓ KEK-u në rastin e këtij konsumatorit ka gabuar në llogaritjen e faturës së shfrytëzimit të paautorizuar me anë të së cilës është ngarkuar konsumatori ngase nuk e ka shkarkuar konsumin mesatar mujor të faturuar nga konsumi mesatar i llogaritur për shfrytëzim të paautorizuar.

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmive të paraqitura rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranojë pjesërisht** ankesën e konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **pranojë pjesërisht** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Ta shkarkojë konsumatorin nga fatura e shfrytëzimit të paautorizuar DPE07HP02441 në shumë prej 10,077.04 €.
2. Ta ngarkojë konsumatorin me shfrytëzim të paautorizuar por vetëm për energjinë e cila nuk është faturuar, pra për 2,230 kWh/muaj.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar
